



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Në mbështetje të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.24 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nenit 30 paragrafi 1 të Rregullore Nr. 03/2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 20 qershor 2023,

Miraton:

RREGULLORE NR. 08 /2023

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORE NR. 11 /2022
PËR EVIDENCËN PENALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullore Nr. 11 /2022 për Evidencën Penale në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Neni 19 i rregullores bazë, pas paragrafit 9 shtohet një paragraf i ri me tekstin si në vijim:

10. Procedurës së rehabilitimit ligjor, të përcaktuar me dispozitat e nenit 96 dhe procedurës së rehabilitimit gjyqësor, të përcaktuar me dispozitat e nenit 97 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, nuk i nënshtrohen dënimet të cilat sipas nenit 93 paragrafi 2, të këtij kodi, nuk krijojnë pasoja juridike.

Neni 3

1. Neni 26 i rregullores bazë, paragrafi 5 riformulohet me tekstin si në vijim:

5. Në certifikatën për dënimet penale, nuk pasqyrohen dënimet të cilat nuk krijojnë pasoja juridike sipas dispozitave të nenit 93 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

2. Neni 26 i rregullores bazë, paragrafi 6 fshihet nga teksti i rregullores.

Neni 4 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Albert Zogaj,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Date: 1.06.2023
